KRONIKA

Sherr mes të rinjve në një lokal në Vlorë, qëllohet me armë zjarri

3 Janar, 2026 62 0

Një sherr mes të rinjve në një lokal në Vlorë ka degraduar në përdorimin e armës së zjarrit. Sipas policisë disa persona janë konfliktuar në ambientet e jashtme të lokalit, dhe njëri prej tyre ka pasur pasur armë zjarri me vete.

Gjatë konfliktit 25-vjeçari ka marrë armën e zjarrit nga shoku i tij, shtetasi 19 vjeç dhe më pas ka qëlluar në ajër.

Të rinjtë janë arrestuar në lagjen "Uji i Ftohtë" në Vlorë.

Njoftimi

Parandalohet një ngjarje e mundshme kriminale me pasoja për jetën, falë reagimit të menjëhershëm të Policisë.

Vihen në pranga dy shtetas, njëri prej të cilëve qëlloi me armë zjarri në ajër, gjatë një konflikti.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Vlorë, pas marrjes së njoftimit se në ambientet e jashtme të një lokali disa persona po konfliktoheshin dhe se njëri prej tyre kishte armë zjarri, ndërhynë menjëherë për parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit, duke arrestuar 2 autorët, konkretisht shtetasit:

* A. H., 19 vjeç, banues në Vlorë;
* M. A., 25 vjeç, banues në Orikum.

Arrestimi i tyre u bë pasi, në lagjen "Uji i Ftohtë", Vlorë, në ambientet e jashtme të një lokali, gjatë një konflikti fizik midis 2 shtetasve të mësipërm dhe disa personave të tjerë, shtetasi M. A. ka marrë armën e zjarrit pistoletë nga shoku i tij, shtetasi A. H., dhe ka qëlluar një herë në ajër.

Falë ndërhyrjes së menjëhershme të shërbimeve të patrullës, u bë e mundur neutralizimi dhe kapja e dy shtetasve, si dhe gjetja dhe sekuestrimi i armës së zjarrit pistoletë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprat penale "Prishja e qetësisë publike" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit".

Artikulli paraprak
Bombardimet në Venezuelë, reagon Trump: SHBA-të kanë kryer një "sulm në shkallë të gjerë", Maduro është larguar…

Artikulli tjetër
Trump njoftoi se Maduro është kapur nga "Delta Force", ministri i Mbrojtjes së Venezuelës: Do rezistojmë

ARTIKUJ TË NGJASHËM MË SHUMË NGA AUTORI

Kronika
E rëndë në Zall Bastar, 44-vjeçarja humb jetën pasi u mor nga rrjedha e lumit

Kronika
DURRES/ Dhunë në familje, aksident, thyerje masës arrestit, policia pranga dhe shpallje në kërkim disa persona

Kronika
34-vjeçari i shpallur në kërkim ndërkombëtar arrestohet në Cërrik

19,354 Fansa PËLQEJE
9,894 Ndjekësit NDJEK
588 Abonentë ABONOHU

EDITOR PICKS

Sir Alex Ferguson hap zemrën në moshën 84 vjeçare jo vetëm për sportin
20 Shtator, 2025

U arrestua me Erzen Breçanin, GJKKO lë në burg Bujar Ajetin! Nuk pranon t'i...
29 Korrik, 2024

Krerët e shtetit përkujtojnë Betejën e Koshares: Dëshmorët i bashkoi kauza e lirisë kundër...
9 Prill, 2024

"Nafta në Shpirag nuk ka energji për të dalë në sipërfaqe", zv/ Dekani i...
23 Mars, 2024

© Copyright Bulevard News. Mundesuar nga Ilirix